

Kontaktimi Odën Ekonomike të Kosovës për të aplikuar dhe më shumë informata



Prishtinë: Njësia Rajonale e Prishtinës
Hivzi Dragidella
Tel: +383 (0)45 667 400
Email: hivzi.dragidella@oek-kcc.org



Mitrovicë: Njësia Rajonale e Mitrovicës
Besart Kostanica
Tel: +383 (0)45 619 519
Email: besart.kostanica@oek-kcc.org



Pejë: Njësia Rajonale e Pejës
Samir Lleshi
Tel: +383 (0)45 560 999
Email: samir.lleshi@oek-kcc.org



Prizren: Njësia Rajonale e Prizrenit
Armend Hyseni
Tel: +383 (0)45 982 715
Email: armend.hyseni@oek-kcc.org



Ferizaj: Njësia Rajonale e Ferizajit
Lulzim Azemi
Tel: +383 (0)45 580 666
Email: lulzim.azemi@oek-kcc.org



Gjilan: Njësia Rajonale e Gjilanit
Ibrahim Tahiri
Tel: +383 (0)45 699 692
Email: ibrahim.tahiri@oek-kcc.org



Gjakovë: Njësia Rajonale e Gjakovës
Behar Ferizi
Tel: +383 (0)45 539 444
Email: behar.ferizi@oek-kcc.org



Mbështetur nga:



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Ministarstva za Obrazovanje i Nauku
Ministry of Education and Science



giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

STEMA E TË MËSUARIT NË VENDIN E PUNËS



Aftësojmë
për punësim!



ODA EKONOMIKE
E KOSOVËS | KOSOVA CHAMBER
OF COMMERCE



TË MËSUARIT NË VENDIN E PUNËS

Ekonomia e Kosovës dhe bizneset janë duke u rritur, por për investime dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik gjithnjë e më shumë po bëhet pengesë mungesa e punëtorëve të kualifikuar. Kompanitë kanë nevojë për punëtorë të kualifikuar që të zhvillohen dhe të bëhen më të përshtatshme për tregun e brendshëm si dhe për klientët jashtë vendit. Për një fuqi punëtoresh dhe një zhvillim ekonomik më të kualifikuar, investimet në Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP) janë të nevojshme si nga sektori publik ashtu dhe nga ai privat.

Nxënësit e shkollave profesionale kanë nevojë për më shumë përvojë praktike në vendin e punës për të zhvilluar aftësitë dhe shkathtësitë të cilat kërkohen në treg. Integrimi i elementeve duale përmes mësimin në vendin e punës në aftësimin profesional është shumë premtues. Ky sistem u ofron ndërmarrjeve të gjejnë punëtorët e kualifikuar që ju nevojiten, përdërisa në anën tjetër u ndihmon të rinjtë të gjejnë një punë të denjë.

Zbatimi i mësimin në vendin e punës kërkon një rol aktiv nga kompanitë dhe stafi profesional i tyre dhe është një investim për ta i cili pa dyshim do të jep rezultate të mira në të ardhmen. Kështu kompanitë njohin nxënës të motivuar, i trajnojnë ata për t'i plotësuar nevojat e tyre dhe në mesin e tyre gjejnë edhe punëtorë të ardhshëm të kualifikuar.

Ky lloj angazhimi duhet të promovohet për të demonstruar përgjegjësinë shoqërore të korporatave. Stema e të Mësuarit në Vendin e Punës e bën të dukshme publikisht kush bashkëpunon me shkollën profesionale, ofron mësimin në vendin e punës, dhe më tej, kush investon në të ardhmen e kompanisë së tij apo të saj, rininë dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës.

10 KRITERET E STEMËS

ANGAZHIM

- 1 Ne marrim nxënës të AAP-së për mësim të bazuar në vendin e punës në kompaninë tonë.
- 2 Ne kemi caktuar një person përgjegjës për mësimin e bazuar në vendin e punës për nxënësit e AAP-së. Ky person kompetent ka përfunduar një trajnim për instruktor në vendin e punës.
- 3 Ne hartojmë një plan trajnimi të ndërmarrjes për nxënësit e AAP-së, në përputhje me kurrikulën përkatëse dhe në konsultim me shkollën profesionale.
- 4 Ne angazhohemi në mënyrë aktive në vlerësimin përfundimtar të nxënësve të AAP-së, duke reflektuar rezultatet që ata kanë arritur gjatë praktikës së tyre profesionale në kompaninë tonë.

CILËSI

- 5 Ne sigurohemi që nxënësit tanë të AAP-së të mbajnë një ditar të punës.
- 6 Ne u ofrojmë nxënësve tanë të AAP-së të gjitha materialet e nevojshme të trajnimit falas, në mënyrë të veçantë veglat, materiale shpenzuese, etj.
- 7 Ne u japim studentëve tanë të AAP-së kompensim të përshtatshëm për punën e tyre.

PËRGJEGJËSI

- 8 Ne zbatojmë dispozitat e Ligjit për Punën, Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, dhe dispozitat e tjera ligjore përkatëse.
- 9 Ne dhe nxënësit e AAP-së respektojmë numrin maksimal të orëve të punës të caktuar me ligj.
- 10 Ne sigurohemi që të mbajmë një ekuilibër në mes të numrit të nxënësve të AAP-së dhe numrit të punëtorëve të kualifikuar që punësojmë.



Si mundet kompania ime të merr pjesë në të Mësuarit në Vendin e Punës?

- A. Identifikoni se çfarë lloj profilesh profesionale po kërkoni dhe ku doni të merrni nxënës nga shkollat profesionale.
- B. Kontaktoni me një shkollë profesionale që ofron programe të arsimit profesional të përshtatshëm për këto profile.
- C. Sqaroni bashkëpunimin me shkollën përkatëse dhe hartoni një marrëveshje bashkëpunimi.

Si mund t'i jepet kompanisë sime Stema e të Mësuarit në Vendin e Punës?

- A. Keni një marrëveshje bashkëpunimi me një shkollë profesionale?
- B. Kontrolloni nëse mund të pajtoheni me 10 kriteret e stemës.
- C. Kontaktoni përfaqësuesin rajonal të Odës Ekonomike të Kosovës dhe dorëzoni një vetë-deklarim ku pajtoheni me 10 kriteret e Stemës e të Mësuarit në Vendin e Punës.
- D. Përfaqësuesi regjional i OEK-ut do të ju kontaktojë në lidhje me aplikimin tuaj.